



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1, pika 6, e në lidhje me nenet 35 dhe 36 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10) dhe nenin 101, paragrafi 2 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09 dhe 67/10), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

V E N D I M

për sigurimin e të dhënave të normave të interesit të bankave për depozitat e pranuar dhe kreditë e dhëna

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra dhe afatet e dorëzimit të të dhënave të normave të interesit për depozitat e pranuar dhe kreditë e dhëna nga bankat në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.

2. Bankat janë të detyruara të dorëzojnë të dhëna të normave të interesit për depozitat e pranuar dhe kreditë e dhëna Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, për nevojat e statistikës monetare.

3. Me normë interesi bankar nga pika 1 e këtij vendimi nënkuptohet:

a) normat e ponderuara të interesit nga bankat për depozitat e marra dhe kreditë e dhëna dhe

6) normat e interesit të bankave për depozitat e marra dhe kreditë e dhëna.

4. Të dhënat e normave të interesit të pikës 3, paragrafi 1 nënpika a) të këtij vendimi, i dorëzohen Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në mënyrë elektronike, çdo muaj, brenda 18 (tetëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të muajit për të cilin raportohet.

5. Të dhënat e normave të interesit të pikës 3, paragrafi 1, nënpika b) të këtij vendimi i dorëzohen Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë çdo muaj, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga fillimi i muajit për të cilin raportohet.

6. Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë nxjerr udhëzim me të cilin përshkruhen formularët e dorëzimit të të dhënave të pikës 4 dhe 5 të këtij vendimi dhe mënyrën e plotësimit të tyre.

7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nuk do të vlejë më Vendimi për dorëzimin e të dhënave të normave të interesit të bankave për depozitat e pranuar

dhe kreditë e dhëna ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/07 dhe 86/10).

8. Ky vendim hyn në fuqi në afat prej tetë ditësh nga botimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Nr.02-15/IX-2/2011
15.09.2011
Shkup

Guvernatori dhe kryetari
i Këshillit të Bankës Popullore
së Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov